REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
KËSHILLI I BASHKISË

Nr.73 Prot Maliq, më 08.01.2026

VENDIM

Nr.8, datë 08.01.2026

"Për përdorimin e fondit për mbrojtjen civile nga të ardhurat e veta"

Në mbështetje të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 54 "Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak" gërma (dh) , Ligjit nr.45/2019 "Për mbrojtjen civile", Vendimit të Këshillit të Bashkisë nr.3, datë 08.01.2026 "Miratimi i buxhetit të Bashkisë Maliq për vitin 2026" , Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor të Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, ligjit nr.68,datë 27.04.2017 "Për financat e qeverisjes vendore" , Këshilli i Bashkisë :

VENDOSI :

1. Të miratojë përdorimin e fondit prej **1,000 mijë lekë** të parashikuar në buxhetin e bashkisë për vitin 2026 nga të ardhurat e veta për "Marrje mjete me qira", për situatën emergjente të përmbytjeve në territorin e Bashkisë Maliq dhe çarjes së argjinaturës së Lumit Devoll.
2. Të bëhet ndryshimi në buxheti si më poshtë:

Pakësim *në 000/lekë*

Gr.	Kap.	Kod. Prog.	Llog.Ek.	Kodi Objekti		
00	05	03280	606	9999999	''Mbrojtja Civile''	**1,000**

Shtesë

Gr.	Kap.	Kod,Prog.	Llog.Ek.	Kodi Objekti		
00	05	03280	602	9999999	"Marrje mjete me qira"	**1,000**

3. Për efekt të mbylljes së çarjes se argjinaturës së Lumit Devoll të përdoren edhe eskavatorët e Bordi të Ujitje –Kullimit të bashkisë për efekt ngarkim shkarkim material mbushës;
4. Për zbatimin e vendimit ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Bordi i Ujitje- Kullimit dhe Sektori i Emergjencave Civile në bashki.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Miratuar me 19 vota
Vota pro 19 "
Vota kundër 2 "
Vota abstenim 0 "
Zbardhur datë 08.01.2026

KRYETARI I KËSHILLIT

ORNILDI DEMOLLARI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ

RELACION

"Për përdorimin e fondit për mbrojtjen civile nga të ardhurat e veta"

Fondi i Emergjencave Civile i parashikuar në buxhetin e Bashkisë Maliq në shumën **1,000 mijë lekë**, parashikuar në buxhetin e bashkisë për vitin 2026 nga të ardhurat e veta ju propozohet të përdoret për "Shpenzime për marrjen e masave parandaluese, lehtësuese, mbrojtëse dhe rehabilituese në objekte të ndryshme ndërtimore në mbrojtjen e jetës dhe në pronësi të njerëzve" me objekt:

1. **"Marrje mjete me qira"**

Situata është emergjente ndaj edhe menduam t'ja u sjellim këtë propozim për efekt të marrjes së mjetve me qira, përkatësisht mjete Tip Fadromë për hapje rrugësh nga rrëshqitjet në territor dhe marrje mjete Tip Kamjon vetshkarkues për transport gurë drejt çarjes së argjinaturës së Lumit Devoll .

Për efekt të mbylljes së çarjes se argjinaturës së Lumit Devoll të përdoren edhe eskavatorët e Bordi të Ujitje-Kullimit të bashkisë për efekt ngarkim shkarkimi material mbushësh.

Konceptoi:

Almira Muka

Genci Floqi

KRYETARI I BASHKISË

GËZIM TOPÇIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ